

FJALA E DEPUTETES KLOTILDA BUSHKA

E MËRKURË 9 NËNTOR 2022

Të dashur qytetarë,

Ne jemi votuar për t'u shërbyer të gjithëve, jo për t'u pëlqyer nga të gjithë dhe, aq më tepër, për t'u pëlqyer nga opozita, nga e cila presim alternativa dhe jo keqinformime të publikut bazuar në fakte të pavërteta, me baltë apo me hi.

Logjika e buxhetit nuk është thjesht shifra, e tha me të drejtë një kolege parafolëse, por janë politika që përkthehen në shifra.

Nisur nga ajo që thashë më parë, që ne duhet t'u shërbejmë qytetarëve, kemi pasur disa parime mbi të cilat kemi punuar dhe do të vijojmë të punojmë edhe sot. Kjo ka të bëjë me realizmin, pra ne jemi realistë në politikat që bëjmë dhe në buxhetimin e tyre, jemi të kthjellët, përpiqemi të vëmë në balancë të gjitha interesat e shoqërisë, që askush të mos mbetet pas, jemi objektivë dhe planifikojmë sipas mundësive, duke optimizuar mirëmenaxhimin e burimeve tona publike.

Pikërisht me këtë mendësi përballuam me sukses një fatkeqësi natyrore, si tërmeti, përballuam me sukses pasojat e pandemisë, bëme ç' ishte e mundur për të miratuar paketat e rezistencës sociale, si dhe për të përballuar çmimin e rritur të energjisë elektrike gjatë këtij viti, me aktet normative që kemi miratuar këtu, në këtë Kuvend, në këtë sallë, ashtu siç po vijojmë të mendojmë me këtë përgjegjshmëri, me këtë objektivitet, me këtë realizëm për projektbuxhetin e vitit 2023, i cili ka si objektiva kryesorë pikërisht të zbusë ndikimet e krizës, duke mbështetur veçanërisht shtresat në nevojë, të mbajë të pandryshuar çmimin e energjisë elektrike dhe të vijojë me konsolidimin fiskal të financave publike.

Unë nuk do t'i përmend ato që parashikohen në buxhetin e vitit 2023, pasi janë përmendur deri tani, do të përmenden edhe nga kolegët e tjerë, por do të doja t'ju flisja pak për parashikimet e buxhetit të shtetit për vitin 2023, lidhur me disa reforma të rëndësishme, siç janë reforma në drejtësi, reforma administrativo-territoriale, mbështetja e institucioneve të pavarura dhe atyre kushtetuese për ushtrimin e funksioneve të veta, të cilat, nëse i marrim zë më zë, do të shohim që në buxhetin e vitit 2023, edhe pse jemi në një vit të vështirë, kur na duhet të përballemi me një krizë të shkaktuar nga lufta në Ukrainë, kanë rritje dhe janë buxhetuar në mënyrë që të kryejnë normalisht funksionet e veta.

Meqenëse thashë se buxheti nuk është shifra, por është politikë, nisur nga fakti që për ne reforma në drejtësi është një nga reformat më të rëndësishme për krijimin e një sistemi drejtësie të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesional dhe të orientuar drejt shërbimeve të hapura, të përgjegjshme dhe eficiente, ajo vijon të mbetet një prioritet edhe në projektbuxhetin e vitit të ardhshëm.

Gjatë vitit 2023 mbështetja buxhetore për të gjitha institucionet e drejtësisë është planifikuar të jetë rreth 9 miliardë lekë më shumë, me një shtesë prej 400 milionë lekësh, krahasuar me vitin e kaluar. Rritjen më të madhe të shpenzimeve buxhetore, krahasuar me vitin 2022, për institucionet e drejtësisë e ka Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar me një rritje prej 123 milionë lekësh, Këshilli i Lartë Gjyqësor me një rritje prej 122 milionë lekësh, Prokuroria e Përgjithshme me 8,5 milionë lekë më shumë dhe organet e vettingut apo të rivlerësimit kalimtar të magistratëve me 48 milionë lekë më shumë.

Nuk dua të ndalem te shifrat, sepse shifrat ju i lexoni, jo të gjithë mund t'i kuptojnë, por dua të ndalem tek thelbi i asaj që arrin të realizojë buxheti i vitit 2023.

Eficienca e sistemit tonë gjyqësor është kryefjalë. Në kuadër të reformës në drejtësi, me vendim të Këshillit të Ministrave, është miratuar një hartë e re gjyqësore, e cila synon të plotësojë të gjitha nevojat që ka publiku sot për një drejtësi më cilësore, të paanshme dhe të pavarur. Në këtë kuadër, harta e re gjyqësore mundëson specializimin e gjykatave dhe të gjyqtarëve në funksione të posaçme dhe jo vetëm kaq, por e njëjta gjë është edhe për funksionet e Prokurorisë. Kjo hartë gjyqësore ka nevojë të buxhetohet, dhe në buxhetin e vitit 2023 kemi një financim jo vetëm për fuqizimin e kapaciteteve, për t'iu përgjigjur implementimit të hartës së re gjyqësore, por edhe për krijimin e kushteve, që sistemi gjyqësor të funksionojë.

Gjykata e Lartë buxhetohet për një godinë të re. Gjykata e Tiranës, gjykata e Fierit dhe gjykata të tjera, në kuadër të hartës së re gjyqësore, do të kenë mundësinë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në godina të rikonstruara, ato që janë ekzistente, por paralelisht do të fillojë puna për projektimin e gjykatave të reja.

Këto gjejnë adresim në buxhetin e vitit 2023, ndërkohë që presim uljen e çështjeve që rrinë pezull në Gjykatën e Lartë; uljen e çështjeve të tjera në gjykata të ndryshme të vendit; shkurtimin e afateve të gjykimit, ndërkohë që qytetarët janë gjithë "sy e vesh" nga drejtësia, dhe drejtësia duhet që të gjithë këtë mbështetje, e cila i është dhënë nga viti 2016 e deri më sot dhe që do të vijojë ta ketë, ta justifikojë

përballë publikut me më shumë pavarësi, me më shumë eficiencë, me më shumë cilësi dhe të fillojë të tregojë përgjegjësinë e leadership-it të vet në të gjitha institucionet ku ajo funksionon.

Ndihma ligjore falas, gjithashtu, merr një buxhet goxha të konsiderueshëm, që i vjen për shtat projektit të ri të hartës gjyqësore. Janë rreth 10 mijë qytetarë që do të përfitojnë gjatë vitit 2023, me mundësinë që, nëse ky numër do të jetë më i madh, buxheti do ta japë pa diskutim këtë mbështetje.

Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar do të ketë mbështetje buxhetore për fuqizimin e sektorit të hetimit financiar, për sa u takon pajisjeve të reja të specializuara për hetime të posaçme.

Prokuroria e Përgjithshme, në funksion të hetimit, do të ketë mbështetje jo vetëm për zërat normalë të punës, por edhe për ekspertizat e posaçme, të cilat do të duhet t'i mbulojë buxheti i shtetit.

Shkolla e Magjistraturës, një nga institucionet më të rëndësishme të sistemit të ri të drejtësisë, është ajo që prodhon magjistratët, të cilët duhet të kenë rolin parësor në kthimin e besimit të publikut te drejtësia. Sigurisht, kjo shkollë sot është përballë sfidave për të rritur numrin e magjistratëve që plotësojnë gjykatat dhe prokuroritë tona, por, nga ana tjetër, kjo nuk është vetëm një sfidë sasiore, kjo është edhe një sfidë cilësore, pasi Shkollës së Magjistraturës do t'i duhet të fuqizojë kapacitetet e veta, që të mundësojë prodhimin e magjistratëve më të mirë, të cilët i duhen sot sistemit të drejtësisë. Pikërisht për këtë arsye, në buxhet është bërë kujdes që Shkolla e Magjistraturës t'i ketë asetet financiare për ta realizuar këtë objektiv të reformës në drejtësi, por, ndërkohë, ky është edhe një objektiv i buxhetit të vitit 2023.

Gjithashtu, edhe institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë kanë rritje buxheti. Unë nuk po i përmend një nga një, pasi do të kemi kohë të diskutojmë edhe në komisionet përkatëse për buxhetet dhe zërat e veçantë për secilin institucion. Ndërkohë, ajo që ka vlerë këtu lidhet me faktin se reforma në drejtësi mbetet një prioritet për vitin 2023, adresuar si i tillë me shifra konkrete të rritura në buxhetin e këtij viti.

Do të ndalem te Ministria e Drejtësisë, e cila gjithashtu ka një buxhet të rritur, krahasuar me vitin 2022, dhe do të përmend vetëm 2 çështje.

Ndërtimi i Institutit të Rehabilitimit të të Miturve në Mëzezë të Tiranës, që, në fakt, është një vepër që duhet ndërtuar sa më parë, jo vetëm si një detyrim i vendosur nga organizatat ndërkombëtare për Shqipërinë, por, së pari, si një detyrim ndaj të rinjve tanë që janë në konflikt me ligjin, të cilët kanë nevojë për kushte dinjitoze, ku të reflektojnë për gabimet e kryera dhe të kenë mundësinë të

riintegrohen në jetë, është një çështje që mbulohet tërësisht nga buxheti, për të filluar puna dhe për ta pasur sa më shpejt këtë shërbim të ri.

Nuk janë lënë pas dore edhe ish-pronarët, vazhdon të jetë fondi i lartë i kompensimit të ish-pronarëve, buxheti për luftën kundër korrupsionit në administratë, si dhe buxheti i Agjencisë së re kundër Korrupsionit, për të cilën do të flasë më shumë ministri. Të gjitha këto unë i shoh të adresuara në buxhetin e vitit 2023 dhe, si komision përgjegjës për këto çështje, ne e përgëzojmë qeverinë, që i ka prioritarë në politikat e saj.

Reforma administrativo-territoriale është shumë e rëndësishme. Buxheti i bashkive, ajo pjesë që i jep pushteti qendror, është në rritje dhe u mundëson të gjitha bashkive të kryejnë funksionet e tyre, të konsolidojnë financat, të kenë mundësi të ulin borxhet dhe, nga ana tjetër, bashkive u kërkohet të rrisin performancën për mbledhjen e të ardhurave për të plotësuar nevojat e veta edhe nga të ardhurat që marrin në territor.

Ajo që është e rëndësishme të theksojmë për bashkitë dhe për shërbimet në nivel lokal: arsimit parashkollor; arsimit parauniversitar; shërbimi i mbrojtjes nga zjarri; administrimi i pyjeve; ujitja; kullimi, është se kanë një fond të shtuar me 340 milionë lekë, i cili shkon edhe për rritjen e pagave. Pra, përveç paketës së rezistencës sociale, ku ne indeksojmë pensionet, japim bonusin e pensionistit, rrisim nivelin e pagës së patatueshme, patjetër subvencionojmë energjinë elektrike, në buxhet kemi edhe paga të rritura për shumë sektorë. Këta janë sektorët e arsimit parauniversitar, shërbimit të zjarrfikëseve, janë shërbime të tjera në arsim dhe mjekësi, që kanë rritje pagash. Të gjitha këto bëhen të mundura nga buxheti i vitit 2023, i cili duhet ta pranojmë se është sa dyfishi i buxhetit të vitit 2013. Kjo është një e vërtetë e pamohueshme, e cila nuk u arrit vetë, por u bë nga një punë e mirë e kryer ndër vite, nga një përgjegjshmëri e lartë dhe nga një planifikim objektiv i kësaj maxhorance, e cila, siç e thashë, është votuar nga shqiptarët për t'u shërbyer të gjithëve, jo për t'u pëlqyer të gjithëve. Ne nuk jemi populistë, ne jemi realistë dhe do të përpiqemi të vijojmë të jemi të përgjegjshëm për të përballuar pasojat e krizës, të cilat nuk i kemi shkaktuar ne, por, fatkeqësisht, do të duhet t'i përballojmë ne.

Faleminderit, kolegë!